

Projekti HEGenAi

Inteligjenca Artificiale gjeneruese për vlerësimin dhe reagimet në arsimin e lartë



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

Inteligjenca Artificiale po revolucionarizon fushën e arsimit, duke riformësuar mënyrën se si studentët mësojnë dhe si pedagogët vlerësojnë. Përmes personalizimit të mësimdhënies, gjenerimit të feedback-ut të menjëhershëm dhe automatizimit të proceseve administrative, A.I. rrit ndjeshëm efikasitetin akademik dhe përgatit brezin e ri për sfidat e të ardhmes digjitale.

Qëllimi i projektit: Ky projekt synon të përmirësojë motivimin, ndërveprimin e menjëhershëm, diskutimin interaktiv, gjenerimin e ideve dhe zbatueshmërinë e vlerësimit dhe feedback-ut në lëndët e programeve të arsimit të lartë multidisiplinar në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe mjekësi (STEM), përmes integritit të mjeteve të Inteligjencës Artificiale Gjeneruese (GenAI). Ideja kryesore dhe aktivitetet e këtij projekti të propozuar paraqiten për herë të parë në kuadër të programit Erasmus+, pasi të gjitha projektet e mëparshme që lidhen me GenAI nuk janë konceptuar dhe zbatuar në fushën e vlerësimit dhe feedback-ut. Projekti bashkon një konsorcium universitetesh dhe partnerësh nga industria, që vijnë nga Evropa, Ballkani Perëndimor dhe Mesdheu Jugor.

Ky projekt parashikohet të zgjasë 3 vjet, me një buxhet total prej 400,000.00 Euro.

Lloji i projektit: Erasmus+ KA2 Project (KA220)

Data e nisjes së projektit: Shtator 2025

Data e mbarimit të projektit: Gusht 2028

Objektivat specifike:

- të sintetizohen kërkimet empirike dhe përvojat institucionale, të përcaktohet fusha e ridizenjimit pedagogjik të bazuar në Inteligjencën Artificiale Gjeneruese (GenAI) dhe të identifikohen mjetet GenAI që përputhen me politikat dhe rregulloret për aktivitetet e vlerësimit dhe feedback-ut në arsimin e lartë;
- të projektohen, zhvillohen, pilotohen dhe vlerësohen module trajnimi për programet e pedagogjisë universitare, me qëllim fuqizimin e kapaciteteve të pedagogëve për përdorimin e vlerësimit dhe feedback-ut të bazuar në Inteligjencën Artificiale Gjeneruese (GenAI);
- të zhvillohen dhe zbatohen instrumente për matjen e ndikimit të moduleve të trajnimit të dedikuara për pedagogët;

Objektivat e përgjithshme: Objektivi i përgjithshëm është integrimi i mjeteve të Inteligjencës Artificiale Gjeneruese (GenAI) për të përmirësuar motivimin, ndërveprimin e menjëhershëm, diskutimin interaktiv, gjenerimin e ideve dhe zbatueshmërinë e vlerësimit dhe feedback-ut në kuadër të programeve multidisiplinare STEM në arsimin e lartë.

Rezultatete e pritshme të projektit:

HEGenAI do të ofrojë: (1) punime shkencore empirike dhe rishikime të vlerësuara nga kolegët (peer-reviewed) mbi zbatimin e mjeteve GenAI, praktikat më të mira dhe sfidat në skenarët e aktiviteteve të vlerësimit dhe feedback-ut në kurset e arsimit të lartë; (2) përvojë ndërhyrjeje të bazuar në dy përsëritje të integritimit pilot të mjeteve GenAI, si dhe vlerësimin e përdorshmërisë, dobishmërisë së perceptuar dhe ndikimit në procesin e të nxënës; (3) module trajnimi për pedagogët dhe studentët; (4) instrumente për vlerësimin e ndikimit të trajnimit dhe rezultatet e vlerësimit të vetë trajnimit.

Koordinatori i Projektit:

- Universiteti Teknik i Danimarkës (DTU)

Partnerët e Projektit:

- Universiteti Teknik Chalmers (CTH)
- Universiteti Teknik Brandenburg Cottbus-Senftenberg (BTU)
- Universiteti Kombëtar An-Najah (ANNU)
- Universiteti Teknik Palestinez Kadoorie (PTUK)
- Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)
- Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UNIEL)

HEGenAI është një projekt i financuar nga programi ERASMUS+ për Ngritjen e Kapaciteteve të Bashkimit Evropian.

CHALMERS
UNIVERSITY OF TECHNOLOGY

Chalmers University of
Technology
Sweden



Palestine Technical
University (PTUK)
Palestine

**UNIVERSITY of
ELBASAN**
"Aleksandër Xhuvani"

Universiteti "Aleksandër
Xhuvani" Elbasan
Albania

b-tu
Brandenburgische
Technische Universität
Cottbus - Senftenberg

Brandenburgische Technische
Universität Cottbus-Senftenberg
Germany



Technical
University of
Denmark
(DTU)
Denmark



An-Najah National
University (ANNU)
Palestine



Mediterranean University
of Albania
Albania